



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 3 Mars 2022

Nr: 118

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË AMBASADËS AMERIKANE, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022

Sot, më datë 03.03.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

KËRKUES: Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me seli në Tiranë, Rruga “Stavro Vinjau”

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 2, datë 02.02.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”

V Ë R E N:

Ambasada e e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për 4 (katër) vëzhgues afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin



6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 02.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyesve të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

